



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për përbërjen formale, kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të autoritetit kombëtar kundër trafikimit me njerëz.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për zbatimin e Planit të Veprimit për Reformën e Administratës Publike.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e obligimeve që dalin nga Raporti nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-184 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) për periudhën 2011-2020.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të ngastrave kadastrale në të cilat ndodhen objektet e ish N. Sh " Rilindja", Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelës së bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Objektit për nevoja të Agjencisë Kosovare të Forenzikës/Ministria e Punëve të Brendshme, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelës së bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtarë dhe organizatat e Grupit të Bankës Botërore, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Z. Mentor Mehmedi, emërohet në cilësinë e këshilltarit të Drejtorit Ekzekutiv të Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar që mbulon edhe Republikën e Kosovës.
2. Vendimi përmes Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i përcillet Fondit Monetar Ndërkombëtar, gjegjësisht konstituencës përkatëse që mbulon Republikën e Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Guvernatorit të Bankës Qendrore
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-201 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

Për Reduktimin dhe ndarjen e mjeteve financiare në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për reduktimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2013 në shumë prej € 9,902,000 nga:
 - 1.1. Ministria e Infrastrukturës, nga ndarjet buxhetore kursen € 9,902,000 si në vijim:
 - 4.1.1. €9,902,000, reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Ndërtimi i Autostradave, me kod 422, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit (R-6)", me kod 13256.
2. Aprovohet kërkesa buxhetore për mjete shtesë në shumë prej €9,902,000 për këto Organizata Buxhetore:
 - 2.1. Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i ndahen mjete shtesë në shumë prej €1,402,000 si në vijim:
 - 2.1.1. €50,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Planifikimit Hapësinor me kod 210-602, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.
 - 2.1.2. €500,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210-603, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, për projektin "Akomolimi i ujit-liqeni në Lumin Ibër në Mitrovicë" me kod 13125.

2.1.3. €52,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210-603, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Punimi i sistemit sekondar të ujësjellësit për dhjetë fshatra të komunës së Deçanit".

2.1.4. €150,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Planifikimit Hapësinor me kod 210-602, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri Kompleksi i varrezave Izbicë-Rezallë".

2.1.5. €120,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210-603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Ndërtimi i kanalizimit fekale në fshatin Burojë", k.k. Skenderaj.

2.1.6. €30,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210-603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Ndërtimi i kanalizimit fekal, lagjja Kodra e Dodës-Irznik-Deçan".

2.1.7. €150,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat e k.k. Malishevë-Drenos, Turijkë, Tërpezë, Bardh etj".

2.1.8. €50,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Ujësjellësi Gjergjicë".

2.1.9. €50,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Ujësjellësi Bajicë".

2.1.10. €60,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Kalanizimi Sankovc".

2.1.11. €40,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Kanalizimi Vuçak".

2.1.12. €100,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Ujërave me kod 210 - 603, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Rregullimi i shtratit të Lumit Toplluha-Suharekë".

2.1.12. €50,000 ndarje buxhetore në nën-programin Departamenti i Planifikimit Hapësinor me kod 210 - 602, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, për projektin e ri "Sheshi i Dëshmorit Ismet Ukaj - Strellc i Epërm".

2.2. Ndahen mjete shtesë në shumë prej €500,000 për Shpenzimet e Paparashikuara, si në vijim:

2.2.1. €250,000 ndarje buxhetore në nën-programin Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131, në kategorinë ekonomike Rezervat.

2.2.2. €250,000 ndarje buxhetore në nën-programin Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131, në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.

2.3. Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i ndahen mjete shtesë në shumë prej €4,000,000

2.3.1. €4,000,000 ndahen për MPMS për transferet sociale për mbulimin e obligimeve ligjore për skemat pensionale dhe skemave tjera. MPMS obligohet që brenda tre ditësh pas nxjerrjes së këtij Vendimi të njoftoj Ministrinë e Financave për ndarjet e këtyre mjeteve sipas nën-programeve.

2.4. Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) i ndahen mjete shtesë në shumë prej €4,000,000

2.4.1. €4,000,000 ndahen për mbulimin e obligimeve për MASHT për nën-programin "Administrata qendrore" me kode 113 për projektin "Blerja e librave" me kod 10144.

3. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për harmonizime brenda organizatave buxhetore, si në vijim:

3.1. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

3.1.1. €7,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, nga kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale, transferohen në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve në nën-program të njëjtë.

3.2. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

3.2.1. €300,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Forca për Sigurinë e Kosovës, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, projekti "Halla sportive, fitnesit - Faza e parë Prishtinë" me kod 12259, transferohen në të njëjtin nën-program, në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale, si vijon:

- €250,000 në projektin "Ndërtimi i objektit të Poliklinikës - Faza e parë Prishtinë" me kod 12267.
- €50,000 në projektin "Pajisje për kërkim shpëtim" me kod 13192.

3.3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

3.3.1. €25,500 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e parakohshme të TMK-së, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, transferohen në nën-program Shërbimet Sociale, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.3.2. €63,800 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, transferohen në nën-program Shërbimet Sociale, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.3.3. €55,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet e hershme të Trepçës, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, transferohen në nën-program Shërbimet Sociale, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.3.4. €130,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Trajnimi Profesional, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, transferohen në nën-program Shërbimet Sociale, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.3.5. €30,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Pensionet për Personat me paaftësi, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, transferohen në nën-program Shërbimet Sociale, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.3.6. €15,500 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Shërbimet Sociale, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, transferohen në të njëjtin nën-program, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.

3.4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

3.4.1. €188,900 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Administrata Qendrore, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Bashkfinancim me IPA" me kod 10847, rialokohen në nën-program të njëjtë, në projektet e reja si vijon:

- €19,000 në projektin "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Kosaq, komuna Novobërdë",
- €30,000 në projektin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllobarë, komuna Glllogovc",
- €20,000 në projektin "Ndërtimi i Arenës në kompleksin memorial Kadri Zeka në Poliçkë, komuna Kamenicë",
- €30,000 në projektin "Blind i trafostacionit për furnizim me rrymë elektrike, komuna Kllokot",
- €30,000 në projektin "Rregullimi i rrugës me kubëza betoni në fshatin Sushiq, komuna Shtërpçë",
- €20,000 në projektin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Maxhunaj, komuna Vushtrri",
- €39,900 në projektin "Rregullimi dhe ndërtimi i trotuareve në Shtime, Davidovc, Godanc, komuna e Shtimes".

3.4.2. €67,765 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Administrata Qendrore, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Rregullimi i shtigjeve të ecjes në favor të zhvillimit të turizmit në rajonin jugor të Kosovës" me kod 13867, rialokohen në nën-program të njëjtë, si vijon:

- €37,765 në projektin ekzistues "Ndërtimi i aneksit të bibliotekës në Suharekë" me kod 13621 dhe
- €30,000 në projektin e ri "Fasadimi i objekteve publike – institucioneve shkollore, komuna Hani i Elezit".

3.5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- 3.5.1. €115,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Universiteti i Gjakovës me kod 978, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, transferohen në nën-program të njëjtë, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- 3.5.2. €50,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Administrata Qendrore me kod 113, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Ndërtimi i Shkollës së mesme Hamëz Jashari në Skenderaj" me kod 13481, rialokohen në nën-program të njëjtë, në projektin "Ndërtimi i shkollës së mesme Prishtinë" me kod 12347.
- 3.5.3. €22,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Administrata Qendrore me kod 113, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Ndërtimi i Shkollës fillore në Belince" me kod 13097, rialokohen në nën-program të njëjtë, në projektin "Ndërtimi i shkollës së mesme Gjakovë" me kod 12344.

3.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- 3.6.1. €220,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Arritjet Sportive me kod 802, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Stadiumi i qytetit Deçan" me kod 13711, transferohen si në vijim:
- €100,000 në nën-programin Sportet e gjëra me kod 801, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve,
 - €50,000 në nën-programin Përkrahja e kulturës me kod 805, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve dhe
 - €70,000 në nën-programin Administrata Qendrore me kod 113, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- 3.6.2. €50,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Përkrahja institucionale për kulturë me kod 803, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, nga projekti "Muzeu i artit bashkëkohorë" me kod 13073, transferohen si në vijim:
- €20,000 në nën-programin Përkrahja e kulturës me kod 805, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve dhe
 - €30,000 në nën-programin Përkrahja institucionale për kulturë me kod 803, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.
- 3.6.3. €30,000 reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore me kod 815, kategoria ekonomike e

shpenzimeve kapitale, nga projekti "Digjitalizimi i materialit zanor" me kod 11021, transferohen si në vijim:

- €15,000 në nën-program të njëjtë, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve dhe
- €15,000 në nën-programin Prezantimet dhe kërkimet për trashëgiminë kulturore me kod 816, në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

4. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për transferin e ndarjeve buxhetore nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër buxhetore si vijon:

4.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

4.1.1. €70,000, reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Agjencioni për Promovimin e Investimeve, me kod 413, kategoria ekonomike e Mallrave dhe Shërbimeve, transferohen në Komunën e Shtërpçës, në nën-programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik me kod 48031, kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime.

4.2. Ministria e Shëndetësisë

4.2.1. €69,800, reduktim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, me kod 711, kategoria ekonomike e Mallrave dhe Shërbimeve, transferohen në Komunën e Malishevës.

Obligohet Komuna e Malishevës që pas nxjerrjes së këtij vendimi brenda 5 ditësh të njoftojnë Ministrinë e Financave – Departamentin e Buxhetit Komunal për nën-programin dhe kategorinë se ku do të ndahen mjetet.

5. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore, të cekura në pikën 2 të këtij Vendimi, që të sjellin në Ministrinë e Financave projektet kapitale individuale për financim.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha organizatat buxhetore të ndikuara me këtë Vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/155

Datë: 05.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Përbashkët i cili do të hartoj raportin për gjendjen e pagesave për pensionet në Kosove në këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësues, Ministria e Administratës Publike, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar dhe
 - 1.3. Përfaqësues, Ministria e Financave, anëtar.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi ta hartoj raportin dhe ta sjellë në Qeveri brenda muajit nëntor të këtij viti.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë